



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.5.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETARIN E BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
LEZHË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 23.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kryetar bashkie dhe për këshillin bashkiak, zona zgjedhore Bashkia Lezhë, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 12, ZAZ nr 13.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Data: . .2023 Nr: 00
Ora:



“Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e kryetarit dhe këshillit të bashkisë Lezhë, qarku Lezhë, në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023”.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor është kompetencë e Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse

KZAZ nr. 12, KZAZ nr 13., kanë depozituar në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të Bashkisë Lezhë dhe për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Lezhë, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës Zgjedhore si për kryetarin dhe për këshillin e bashkisë Lezhë, u kontrolluan Tabelat Përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 12, ZAZ nr 13, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Lezhë dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen këshillit të Bashkisë Lezhë, Qarku Lezhë, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lezhë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Pjerin Ndreu si Kryetar i Bashkisë Lezhë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Lezhë, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: . .2023 Nr:
Ora:



“Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e kryetarit dhe këshillit të bashkisë Lezhë, qarku Lezhë, në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA LEZHË, QARKU LEZHË

Lidhja 1



		ZAZ 12	ZAZ 13	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	45.187	45.330	90.517
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	17.974	17.619	35.593
3	Vota të pavlefshme	522	362	884
4	Vota të vlefshme	17.435	17.240	34.675
5	Fletë votimi të hedhura gabim	17	17	34
1	Pjerin Zef Ndreu	9.301	8.998	18.299
2	Pashk Preng Gjoni	8.134	8.242	16.376
	Totali i votave të vlefshme	17.435	17.240	34.675

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA LEZHË, QARKU LEZHË



Lidhja 2

		ZAZ 12	ZAZ 13	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	45.187	45.330	90.517
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	17.978	17.608	35.586
3	Vota të pavlefshme	658	679	1.337
4	Vota të vlefshme	17.313	16.915	34.228
5	Fletë votimi të hedhura gabim	7	14	21
1	Bashkë Fitojmë	2.286	2.138	4.424
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	3.068	2.802	5.870
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	637	524	1.161
4	Partia Republikane Shqiptare	479	1.143	1.622
5	Partia Levizja e Legalitetit	329	521	850
6	Partia Demokracia Sociale	406	545	951
7	Aleanca Liberale e Djathtë	215	175	390
8	Partia Socialdemokrate	2.717	2.154	4.871
9	Partia Demokratike	871	790	1.661
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	251	281	532
11	Fryma e Re Demokratike	416	237	653
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	284	225	509
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	323	222	545
16	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	146	134	280
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	786	785	1.571
18	Partia Balli Kombëtar	356	195	551
22	Partia Unitetit Kombëtar	1.220	686	1.906
23	Partia e Gjellbër	1.055	477	1.532
34	Partia Kristian Demokratike	705	2.528	3.233
40	Ardhmëria Shqiptare	763	353	1.116
	Totali i votave të vlefshme	17.313	16.915	34.228

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI